

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 10.08.2015]

Për: Bashkimin e Operatoreve ekonomike “B 93” shpk (60%), me NIPT J62903508R dhe “Be Is” shpk (40 %) me NIPT K71412003A.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Rikonstruksion i rrugës kthesa e Bishanit – Boçovë – varrezat e fshatit Bashkim, Komuna Levan”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugës kthesa e Bishanit – Boçovë – varrezat e fshatit Bashkim, Komuna Levan”.**

Kohëzgjatja: **6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **73,222,470 (shtatëdhjetë e tre milion e dyqind e njëzet e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 26.06.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: Nr	Operatori Ekonomik	Oferta (pa TVSH)
1	GRAND	39,543,500
2	KONSTRUKSION M	
3	BOSH NJAKU B	45,879,300
4	B 93	48,847,600
5	AL ASFALT	50,515,000
6	BEAN	51,341,900
7	RSM & CAUSHI	53,901,190
8	SIRETA 2F	57,777,775
9	SALILLARI	58,199,500
10	ROSI	62,358,700
11	GPG	65,801,000
	XHA	66,827,040

12	GLAVENICA	NUK KA PARAQITUR OFERTE
13	PESE VELLEZERIT	NUK KA PARAQITUR OFERTE
14	ZDRAVO	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem me arsyet perkatese:

1. Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Grand Konstruksion M” shpk (44.8%), “Shkelqimi 07” (41.2%) shpk dhe “Sardo” shpk (14%) per arsye se:

Shoqeria “Grand Konstruksion M” shpk nuk ploteson kerkesen per numrin e punonjesve, pasi ka paraqitur vertetime ku deshmohe se numri mesatar I punonjesve per periudhen dhjetor 2014 – maj 2015 eshte 15,5 punonjes nderkohe qe sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper i takon te kete 31 punonjes.

2. Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Boshnjaku B” shpk (63.1%) dhe “Shendelli” shpk (36.9%) per arsye se:

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti kjo kompani ka paraqitur :

☐ Kontraten “Rehabilitimi i rruges Goras Aranitas”, me vlere 29.093.791 leke me tvsh, realizuar si bashkim shoqerish. Ne kete kontrate shoqeria “Boshnjaku B” shpk ka kryer punime me vlere 12.364.861 leke pa tvsh.

☐ Kontraten “Rikonstruksion shkolla Mark Lulaj Shkoder”, me vlere 159.735.807 leke me tvsh, realizuar si bashkim shoqerish. Ne kete kontrate shoqeria “Boshnjaku B” shpk ka kryer punime me vlere 93.179.221 leke pa tvsh. Kjo pune nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me objektin qe prokurohet.

☐ Kontraten “Kanalizimet Llakatund dhe Shushice”, me vlere 38.762.447 leke me tvsh. Ne kete kontrate shoqeria “Boshnjaku B” shpk ka kryer punime me vlere 32.302.039 leke pa tvsh. Kjo pune nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me objektin qe prokurohet.

☐ Kontraten “Asfaltimi i rrugeve Lazaren”, me vlere 32.737.608 leke me tvsh, realizuar si bashkim shoqerish. Ne kete kontrate shoqeria “Boshnjaku B” shpk ka kryer punime me vlere 10.912.536 leke pa tvsh.

☐ Kontraten “Ujesjellesi Roskovec”, me vlere 37.350.521 leke me tvsh, realizuar si bashkim shoqerish. Ne kete kontrate shoqeria “Boshnjaku B” shpk ka kryer punime me vlere 28.012.891 leke pa tvsh. Kjo pune nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me objektin qe prokurohet.

Perfundimisht rezulton se kjo shoqeri ka kryer pune te ngjashme ne nje objekt te vetem ne shumen maksimale prej 12.364.861 leke nga 36.611.250 leke qe duhet te kishte realizuar (si anetar i bashkimit te shoqerive me perqindjen me te madhe). Gjithashtu shuma e puneve te ngjashme eshte 23.277.397 leke nga 92.406.757 leke punime qe duhet te kishte kryer ne baze te perqindjes se puneve qe ka marre persiper.

Shoqeria “Shendelli” shpk nuk ka ne stafin e saj inxhinier hidroteknik, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime ne veprat e artit ku inxhinieri hidroteknik eshte i domosdoshem.

3. Shoqeria “Bean” shpk per arsye se:

Kjo shoqeri nuk ploteson kerkesen per gjendjen ne banke. Kjo kompani ka paraqitur nje vertetim se disponon gjendje ne banke ne masen 6.940.357 leke, nderkohe qe sipas kerkeses per kualifikim duhet te dispononte jo me pak se 7.322.247 leke.

4. Bashkimi i perkohshem i shoqerive “RSM Company” shpk (51.5%) dhe “Caushi” shpk (48.5%) per arsye se:

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti kjo kompani ka paraqitur :

☐ Kontraten “Rikonstrukcion carshia e madhe Gjakove”, me vlere 219.945 euro. Per kete kontrate ka paraqitur fatura me vlere 118.628 euro + 43.103 euro + 27.875 euro = 189.606 euro ose 26.544.840 leke dhe nuk ploteson punen si nje pune e vetme per shoqerine kryesuese.

☐ Kontratën “Ndertimi i rruges Ahmet Krasniqi”, me vlere 896.957 euro. Per kete kontrate ka paraqitur nje fature tatimore ne vleren 101.302 euro ose 14.182.280 leke.

Perfundimisht rezulton se kjo shoqeri ka kryer pune te ngjashme ne nje objekt te vetem ne shumen maksimale prej 26.544.840 leke nga 36.611.250 leke qe duhet te kishte realizuar (si anetar i bashkimit te shoqerive me perqindjen me te madhe). Gjithashtu shuma e puneve te ngjashme eshte 40.727.120 leke nga 75.419.144 leke punime qe duhet te kishte kryer ne baze te perqindjes se puneve qe ka marre persiper.

Shoqeria “RSM Company” shpk nuk ploteson kerkesen per shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, pasi nuk ka paraqitur vertetim qe shoqeria nuk ka detyrime, por nje kontrate qeraje me z. Hazbi Parllaku dhe nje vertetim nga OSHEE qe z. Parllaku nuk ka detyrime. Keto dokumente nuk provojne qe shoqeria nuk ka detyrime.

5. Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Rosi” shpk (19%), “Leon” (53%) shpk dhe “Hito 94” shpk (28%) per arsye se:

Kompania “Rosi” shpk nuk ploteson kerkesen per gjendjen ne banke. Kjo kompani ka paraqitur nje vertetim se disponon gjendje ne banke ne masen 750.000 leke, nderkohe qe sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper duhet te dispononte jo me pak se 1.391.226 leke.

6. Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Xhast” shpk (40%) dhe “Arifaj” shpk (60%) per arsye se:

Bashkimi i shoqerive nuk eshte bere ne perputhje me nenin 74, pika 2, te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku nder te tjera citohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Ne marreveshjen e lidhur para noterit eshte percaktuar vetem perqindja e pjesemarrjes per secilen shoqeri dhe nuk jane percaktuar elementet konkrete te punes qe do te kryejë secili nga anetaret e bashkimit. Ne kete menyre eshte e pamundur qe KVO te gjykoje per plotesimin e kerkesave per kualifikim. Ndarja e puneve eshte e panoteruar dhe, si e tille, nuk mund te pranohet.

7. Shoqeria “Glavenica” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.**8. Shoqeria “Pese Vellezerit” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.****9. Shoqeria “Zdravo” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e Operatoreve ekonomike **“B 93” shpk (60%) & “Be Is” shpk (40 %)** se oferta e paraqitur, me vlerë **48.847.600 (dyzet e tete milion e teteqind e dyzet e shtate miqe e gjashteqind)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi përfundimtar i Klasifikimit është bërë në datë **22.07.2015**.

Ankesa: Ne datën 24.07.2015 u paraqit ankimi nga bashkimi i shoqerive “Boshnjaku B” shpk dhe “Shendelli” shpk. Ankimit ju kthye përgjigje ne datën 30.07.2015 duke mos pranuar ankimin. Ne datën 28.07.2015 u paraqit ankimi nga bashkimi i shoqerive “RSM Company” shpk dhe “Caushi” shpk. Ankimit ju kthye përgjigje ne datën 30.07.2015 duke mos pranuar ankimin